



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

---

**Fakulteti:** Bujqësisë dhe veterinarisë

**Departamenti:** Pemëtari - Vreshtari

**Programi:** Pemëtari Vreshtari

**NJOFTIM**

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti ) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Adni Islami, me titull:  
**“Përcaktimi i strukturës dhe vlerësimi i drurëve dekorativ në sheshin Nënë Tereza, Prishtinë ”**

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 13 deri me datë 19.01.2025.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. dr. Bedri Dragusha kryetar
2. Prof. asoc. Vahid Avdiu mentor - anëtar,
3. Prof. asoc. Mentor Thaqi anëtarë, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. asoc. Vahid Avdiu, përmes e-mail adresës vahid.avdiu@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji është i mirëseardhur dhe mund të jetë një pasurim i punës tonë !

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**

**DEPARTAMENTI PEMËTARI -VRESHTARI**

**PROGRAMI PEMËTARI -VRESHTARI**



**PUNIM I DIPLOMËS MASTER**

**PËRCAKTIMI I STRUKTURËS DHE VLERËSIMI I DRURËVE DEKORATIV NË  
SHESHIN “NËNË TEREZA”, PRISHTINË**

**Mentor:**

**Prof. Ass. Dr. Vahid Avdiu**

**Kandidati:**

**Bsc. Adni Islami**

**Prishtinë, 2025**

## ABSTRAKTI

Drunjtë dekorativë në hapësirat urbane përfaqësojnë më shumë sesa elementë estetikë; ata janë thelbësorë për përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe krijimin e qyteteve të qëndrueshme. Me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e ajrit, balancimin termik dhe menaxhimin e ujërave të shiut, këto pemë përbëjnë një aset të çmuar ekonomik dhe ekologjik për komunitetet urbane. Ky studim synon vlerësimin e drurëve dekorativë në sheshin “Nënë Tereza” në Prishtinë, duke i dhënë përparësi vlerës monetare dhe jo-monetare të tyre. Në fokus janë identifikimi i specieve, vlerësimi i shëndetit të tyre dhe analiza e ndikimit të tyre në cilësinë e jetesës urbane. Metodologjia përfshin faktorë kyç si: Çmimi bazë (A): Përcaktimi i vlerës fillestare të pemës në fidanishte. Faktori i moshës (B): Vlerësimi i moshës për të matur ndikimin e rritjes dhe zhvillimit të pemës. Vendndodhja dhe mbrojtja (C): Analiza e pozicionimit strategjik të pemës në hapësirën urbane. Gjendja e kurorës (D): Vlerësimi vizual i shtrirjes dhe dendësisë së kurorës. Gjendja e përgjithshme (E): Matja e shëndetit të pjesëve kryesore të pemës, si rrënjët, trungu dhe gjethet. Vlera dendrologjike (M): Analiza e rëndësisë biologjike dhe estetike të llojit të pemës. Përdoret një qasje e avancuar bazuar në modelin hungarez të miratuar nga Komisioni Evropian. Rezultatet tregojnë se drunjtë dekorativë të vlerësuar kanë një ndikim të shumëfishtë në përmirësimin e cilësisë së jetës urbane dhe planifikimin e qëndrueshëm të qyteteve. Integrimi i këtyre vlerave në strategjitë urbane rekomandohet për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e gjelbërimit. Ky studim thekson domosdoshmërinë e trajtimit të drurëve dekorativë si elementë të domosdoshëm të planifikimit urban. Modelet gjithëpërfshirëse të vlerësimit, si ai hungarez, ofrojnë bazën për politikë bërje efektive që pasuron jetesën në qytetet e shekullit XXI. Gjithsej në sheshin “Nënë Tereza” janë të pranishme 28 lloje të drurëve dekorativë. Gjithsej janë regjistruar 195 drurë dekorativë, me një total të përgjithshëm prej 821,188.2 euro.

Fjalët kyçe: Drurë dekorativë, vlerësim, qëndrueshmëri, mjedis urban.